



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I ARTEVE
ADMINISTRATORI

Nr. 1876 Prot.

Tiranë, më 31.10.2025

URDHËR

Nr. 134, Datë 31.10.2025

PËR

**KRYERJEN E PAGESËS SË TARIFËS SË SHKOLLIMIT PËR CIKLIN E PARË
DHE TË DYTË TË STUDIMEVE, PËR VITIN AKADEMIK 2025-2026, NË
UNIVERSITETIN E ARTEVE**

Mbështetur në nenin 113, pika 3 të ligjit nr. 44/2015, datë 30.04.2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, në nenin 3, pika 3, germa “ç”, në nenin 51 dhe 52, në nenin 98, pika 2, germa “c” të ligjit nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë”, në VKM nr. 269, datë 29.3.2017 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret e pranimit në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale, që përjashtohen nga tarifa vjetore e shkollimit”, e ndryshuar, në VKM nr. 778, datë 26.12.2018 “Për një ndryshim dhe shtesë në vendimin nr. 288, datë 21.05.2018 të Këshillit të Ministrave...”, në Udhëzimin e Minsitrisë së Arsimit dhe Sportit nr. 27, datë 29.12.2017 “Për strukturat e brendshme akademike dhe administrative në institucionet publike të arsimit të lartë”, në VBA nr. 15, datë 13.06.2019 “Mbi miratimin e tarifave të ciklit të dytë të studimeve për studentët mbetës dhe përsëritës në fakultetet e Universitetit të Arteve”, në VBA nr. 25, datë 13.07.2020 “Mbi zbatimin e VKM nr. 778, për përfitimin e reduktimit të tarifës së shkollimit, në Universitetin e Arteve”, në Vendimin e Bordit të Administrimit nr. 4, datë 21.02.2025 “Për miratimin e propozimit të tarifave të konkurrimit, tarifës së regjistrimit dhe të tarifës së shkollimit program i parë studimi si dhe tarifës së shkollimit program i dytë studimi, për të gjitha programet e studimit të ofruara nga fakultetet në Universitetin e Arteve, për vitin akademik 2025-2026”,

URDHËROJ:

1. Kryerjen e pagesës së tarifës së shkollimit nga të gjithë studentët e ciklit të parë dhe ciklit të dytë të studimeve, për vitin akademik 2025-2026, në Universitetin e Arteve.
2. Studentët e ciklit të parë të studimeve Bachelor, në të 3 (tre) fakultetet e UART, të kryejnë pagesën (e plotë) vjetore të tarifës së shkollimit deri më datë 15.11.2025.

3. Studentët e ciklit të dytë të studimeve Master, në të 3 (tre) fakultetet e UART, të kryejnë pagesën e kështit të parë (50% e shumës totale) të tarifës së shkollimit deri më datë 15.11.2025. Kësti i dytë të paguhet para fillimit të sezonit të provimeve të semestrit të parë.
4. Pagesat e kryera sipas pikës 2 të këtij urdhri do t'u kthehen studentëve të ciklit të parë të studimeve, të cilët me Vendim të Bordit të Administrimit do të përjashtohen nga detyrimi për të paguar tarifën e shkollimit.
5. Studentët që nuk përmbushin detyrimin e pagesës së tarifës së studimit do të përballen me penalitetet e parashikuara në rregulloren e studimeve të fakultetit përkatës.
6. Mandatpagesa gjendet në faqen zyrtare të UART.
7. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, sekretaritë mësimore pranë fakulteteve të Universitetit të Arteve dhe Drejtoria Ekonomike.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

ADMINISTRATORI



Alma Sinanaj